



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë -Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine -Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Kabineti i Ministres - Kabinet Ministra - Cabinet of the Minister


01 ref.86
22.04.2022

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 10, 11, dhe 17 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare Nr. 7/01 mars 2019), Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr. 04/2019 për caktimin e formës, përmbajtjes dhe përdorimit të logos të drejtorisë së përgjithshme të akreditimit të Kosovës dhe simbolit të akreditimit dhe referimi i tekstit në akreditim, nenit 8 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 dhe Shtojcës 12 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, merr:

V E N D I M

për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr. 04/2019 Për caktimin e formës, përmbajtjes dhe përdorimit të logos të drejtorisë së përgjithshme të akreditimit të Kosovës dhe simbolit të akreditimit dhe referimi i tekstit në akreditim.

1. Plotësohet tabela e prezantimit të Simbolit të akreditimit edhe me simbolin e akreditimit për laboratorët mjekësorë, të Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr. 04/2019 Për caktimin e formës, përmbajtjes dhe përdorimit të logos të drejtorisë së përgjithshme të akreditimit të Kosovës dhe simbolit të akreditimit dhe referimi i tekstit në akreditim, me tekstin si në vijim:

Simboli i akreditimit	Shpjegim
	Simboli i akreditimit për laboratorët mjekësor të akredituar sipas SK ISO 15189. 000-Numri i akreditimit



Simboli i akreditimit për laboratorët mjekësor të akredituar sipas SK ISO 15189.

000-Numri i akreditimit

2. Ky vendim është pjesë përbërëse e Udhëzimit Administrativ (MTI) Nr. 04/2019 Për caktimin e formës, përmbajtjes dhe përdorimit të logos të drejtorisë së përgjithshme të akreditimit të Kosovës dhe simbolit të akreditimit dhe referimi i tekstit në akreditim.

3. Ky vendim hyn në fuqi pasi të botohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës



Rozeta HAJDARI

Rozeta Hajdari
Ministre

U dërgohet:

- Kabinetit të Ministres;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Kosovës;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MINT-it.